

CSDG

Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Raportimi mbi Sinjalizimin në Mediat Shqiptare

*Për një rol më të angazhuar të gazetarëve në
përmirësimin e raportimit mbi Sinjalizimin*

Ben Andoni

Prill 2020

Raportimi mbi Sinjalizimin në Mediat Shqiptare:

Për një rol më të angazhuar të gazetarëve në përmirësimin e raportimit mbi Sinjalizimin

Ben Andoni

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes

Prill 2020



Ky raport u realizua në kuadër të projektit “Sinjalizimi në veprim: Zbulimi dhe korrigjimi i korrupsionit në Evropën Juglindore përmes mbështetjes së sinjalizuesve dhe forcimit të të drejtave të fjalës së lirë”, të financuar nga National Endowment for Democracy dhe të zbatuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. Opinione të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionet dhe qëndrimet e National Endowment for Democracy.

Hyrje

Sinjalizimi është raportimi nga sinjalizuesi i informacionit për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni të kryera në vendin e punës së sinjalizuesit. Komisioni Evropian përkufizon si sinjalizues njerëzit, që flasin kur hasin në kontekstin e punës së tyre keqbërje të cilat mund ta dëmtojnë interesin publik, për shembull duke e dëmtuar mjedisin, shëndetin publik dhe sigurinë e konsumatorit si edhe financat publike të BE-së.

Në dy dekadat e fundit, sinjalizimi po njihet gjithnjë e më shumë si një mjet i rëndësishëm për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit dhe praktikave të tjera në dëm të interesit publik.¹ Duke vlerësuar rëndësinë e sinjalizimit si mjet për të luftuar korrupsionin dhe praktikave të tjera të kundërligjshme, një sërë konventash ndërkombëtare theksojnë nevojën për mbrojtjen e sinjalizuesve. Për rrjedhojë, një sërë vendesh kanë miratuar kuadër ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, përfshirë dhe Shqipërinë e cila ka miratuar një ligj të tillë në vitin 2016.

Ligji ka gjetur zbatim të dobët në këto vite, dhe raporte të ndryshme kanë vënë në pah dhe analizuar shkaqe dhe rrethanat penguese institucionale dhe administrative të zbatimit të tij. Por përveç faktorëve të sipërpërmendur raportet kanë vënë në pah edhe pengesa që lidhen me kulturën dhe paragjykimet mbi sinjalizimin si faktorë pengues.

Pothuaj në të gjitha vendet e Europës Juglindore u bë një përparim konkret në dekadën e dytë të shekullit XXI. Që nga viti 2011, tre vende - Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia - miratuan ligje të përcaktuara sa i përket sinjalizuesve. Në pesë vende të tjera, ligjet e propozuara ose opsionet legislative u zhvilluan si proces nga viti 2013. Gjatë të gjithë kësaj kohe, shumë institucione qeveritare dhe OJQ e zgjeruan punën e tyre për një sërë çështjesh të sinjalizimit.

Rezultatet në Ballkan të Sinjalizimit, megjithë rastet e raportuara, janë larg pritshmërisë. Ligjet për Sinjalizimit në Ballkan konsiderohen përgjithësisht të hartuara mirë, përveç në disa shtete që nuk ofrojnë mbrojtje e duhur, siç janë Bullgaria dhe Rumania. Sidoqoftë, aplikimi dhe efikasiteti i Sinjalizimit, është kudo në dyshim në Ballkan. Në një mjedis politik sfidues, si ai i Ballkanit, është mjaft e vështirë të sigurosh dhe të ruash mbrojtje për njerëzit që duan të raportojnë korrupsionin dhe kundravajtjet në përgjithësi.

Sa i përket Shqipërisë, vështirësitë lidhur me faktorët politikë, institucionale dhe administrative ishin të kuptueshme për shkak të kontekstit tranzitor të demokracisë shqiptare, por keq raportimi apo raportimi negativ mbi sinjalizimin nga gazetarët e mediave në Shqipëri është më pak i lehtë për t'u interpretuar.

Nisur nga ky kontekst, ky raport studimor ka për qëllim të analizojë shkaqet dhe motivet që i përcjell gazetarët në Shqipëri drejt raportimit negativ të sinjalizimit si edhe të identifikojë veprimet e duhura specifike për të ndryshuar qasjen raportuese dhe përmirësuar aftësitë e gazetarëve në trajtimin e rasteve që përfshijnë sinjalizimin.

Raporti mbështetet në të dhëna nga kuadri ligjor, raporte vendore dhe ndërkombëtare si dhe në të dhëna nga intervista të kryera me 13 gazetarë që punojnë në median e shkruar dhe atë

¹ Artikuj apo studime të kryera deri në vitin 2016, i referohen kësaj praktike si “bilbilfryrje” dhe sinjalizuesve si “bilbilfryrës”. Në Mars të vitit 2015 Ambasada e Holandës në Shqipëri realizoi një konkurs për të patur një përkufizim sa më të saktë të termit në gjuhën shqipe. Projektligji, i cili u depozitua dhe u miratua më pas në Kuvend vendosi përdorimin e termave “sinjalizim” dhe “sinjalizues”. Për të shmangur konfuzionin, në këtë artikull përdoret termi sinjalizim dhe sinjalizues edhe për referenca të mëparshme se viti 2016.

² Whistleblower Protection in Southeast Europe, An Overview of Laws, Practice, and Recent Initiatives (2015)

online, fushat e raportimit të cilëve lidhen me problemet politike dhe të kronikës, ku përfshihen më së shumti problemet e sinjalizimit.

Intervistat u kryen nëpërmjet një pyetësi të strukturuar (Shtojca 1). Të dhënat e marra nga intervistat u shkruan para së gjithash dhe u redaktuan, duke ua rikthyer për konfirmim të intervistuarve dhe më pas të dhënat tekstuale u klasifikuan dhe u bë interpretimi duke krijuar temat në vijim: (1) shkalla e informimit të gazetarëve mbi sinjalizimin dhe ligjin për sinjalizimin, (2) shkaqet përse gazetarët raportojnë negativisht, (3) shkalla e angazhimit dhe përpjekjet e gazetarëve për të përmirësuar raportimin, si dhe (4) dhënien e opinioneve për rrugët e mundshme për përmirësimin e raportimit mbi sinjalizimin. Për të përdorur në mënyrë sa më të lirshme përgjigjet e marra, gazetarët nuk janë cituar kur përdoren pjesë të veçanta nga intervistat.

Gjetjet e studimit tregojnë se gazetarët kanë një informim të dobët mbi ligjin dhe sinjalizimin në përgjithësi. Shkaqet e keq raportimit lidhen me mungesën e njohjes mbi sinjalizimin si temë specifike por edhe me strukturën e organizimit të mediave në përgjithësi, e cila pengon specializimin dhe dekurajon angazhimin gazetaresk.

Raporti rekomandon kryerjen e ndërhyrjeve konkrete nëpërmjet përhapjes së informacionit dhe trajnimeve të vazhdueshme të gazetarëve si dhe inkurajimit të gazetarëve të rinj për të përmirësuar raportimin dhe kontribuar në ndryshimin e opinionit jo pozitiv të krijuar.

Sinjalizimi, kuadri ndërkombëtar dhe kuadri ligjor shqiptar

po njihet gjithnjë e më shumë botërisht si një mjet i rëndësishëm për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit dhe praktikave të tjera në dëm të interesit publik. Nëpërmjet zbulimeve të tyre, sinjalizuesit kanë kontribuar në parandalimin e dëmeve ndaj interesit publik, inkurajimin në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe kanë kontribuar për forcimin e shtetit të së drejtës. Nga ana tjetër, sinjalizuesit shpesh ekspozohen kundrejt një sërë pengesash, si hakmarrja, pushimi nga puna, ngacmime të natyrave të ndryshme apo edhe deri në sulme fizike.

Një sërë aktesh dhe konventash ndërkombëtare të miratuara gjatë 15 viteve të fundit theksojnë nevojën për lehtësimin e sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (2004),³ Vendimi i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në rastin Guja kundër Moldavisë (2008),⁴ Rekomandimi Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2014), si dhe Direktiva e Bashkimit Europian (2018)⁵ e cila për herë të parë krijon një kuadër raportimi dhe mbrojtjeje për sinjalizuesit në të gjithë Unionin.

Kjo ka bërë që shumë vende, përfshirë edhe ato në rajonin e Europës Juglindore, të miratojnë ligje dhe ndërtojnë institucione për të lehtësuar sinjalizimin dhe për të mbrojtur sinjalizuesit në rast të ndërmarrjes së veprimeve shpaguese ndaj tyre.⁶

³ https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf

⁴ <https://www.google.com/search?client=firefox-b-d&q=European+Court+of+Human+Rights+%28ECtHR%29+Guja+v.+Moldova+%2814277%2F04%29#>

⁵ [https://www.europarl.europa.eu/RegData/docs_autres_institutions/commission_europeenne/com/2018/0218/COM_COM\(2018\)0218_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/docs_autres_institutions/commission_europeenne/com/2018/0218/COM_COM(2018)0218_EN.pdf)

⁶ <https://see-whistleblowing.org/>

Në reagim të prirjes për të miratuar korniza ligjore dhe institucionale, Shqipëria ka miratuar legjislacion për të inkurajuar sinjalizimin dhe mbrojtur sinjalizuesit. Në vitin 2006, mbas ratifikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,⁷ Shqipëria miratoi ligjin për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit (Ligji 9508/2006).⁸

Ligji 9508/2006 ka për qëllim të nxisë pjesëmarrjen e publikut në denoncimin e korrupsionit duke përcaktuar kuadrin për denoncimin, hetimin administrativ, mbrojtjen dhe shpërblimin nga 50.000 deri në 1.000.000 lekë të qytetarëve dhe zyrtarëve publikë që denoncojnë akte korruptive.

Duke qenë se ky ligj përmban mangësi në përputhshmërinë me Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në vitin 2016 Shqipëria miratoi Ligjin për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe akte nënligjore për zbatimin e tij.⁹ Ligji parashikon tri elementet themelore të një kuadri të plotë sinjalizimi dhe mbrojtjeje:

- mekanizmat për sinjalizimin e veprave korruptive.
- mekanizmat për hetimin e sinjalizimeve të kryera.
- mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja.

Përsa i përket masave për mbrojtjen e sinjalizuesve, ligji parashikon:

- mbrojtje të konfidencialitetit dhe anonimitet për sinjalizuesin.
- mbrojtje kundër ngacmimeve, që synojnë të krijojnë një mjedis të rënduar për sinjalizuesin.
- ndalimin e marrëveshjeve kontraktuale në bazë të së cilave përjashtohen ose kufizohen të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesit.
- mundësinë e transferimit në rast se sinjalizuesi në mënyrë që të mbrojë veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës zgjedh që të mos punojë në të njëjtin vend pune.
- ngarkimin me përgjegjësi personale për hakmarrje ndaj sinjalizuesit.

Ligji parashikon krijimin e njësite të sinjalizimit në të gjitha institucionet publike me 80 punonjës dhe ato private me deri 100 punonjës. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) është institucioni kryesor, i cili mbikëqyr zbatimin e ligjit si dhe ofron këshillim dhe mbështetje në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve. ILDKPKI shërben si njësi e sinjalizimit për institucione të sektorit publik me më pak se 80 punonjës dhe ato private me më pak se 100 dhe kur sinjalizuesit zgjedhin të mos e kryejnë sinjalizimin së brendshmi për arsye të ndryshme të parashikuara në ligj.

Sinjalizimi dhe praktika zbatuese në Shqipëri

Megjithëse Shqipëria ka në fuqi dy ligje, të cilat të marra së bashku japin një kuadër disi më të plotë, numri i rasteve kur punonjësit vendosin të sinjalizojnë duke u mbështetur tek korniza ligjore për sinjalizimin mbetet shumë i ulët.

Për sa i përket zbatueshmërisë së ligjit për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit nuk ka të dhëna, pasi nuk ka ndonjë institucion përgjegjës raportues për zbatimin

⁷ Ligji nr 9492 datë 13.03.2006 Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit

⁸ Ligji nr. 9508, datë 3.04.2006, Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit

⁹ Ligji nr.60/2016, Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, Fletoren Zyrtare 23 Qershor 2016

e tij. Ndërsa për zbatueshmërinë e Ligjit të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve ILDKPKI-ja, ka nxjerrë të dhëna nëpërmjet raporteve vjetore.

Gjatë vitit 2017, i cili përbën vitin e parë të zbatueshmërisë së plotë të ligjit, janë regjistruar nga ILDKPKI 8 raste sinjalizimi dhe 1 rast kërkesë për mbrojtje,¹⁰ ndërsa në vitin 2018 janë regjistruar 16 raste sinjalizimi dhe 3 raste kërkesë për mbrojtje.¹¹

Vlerësime të kryera nga organizata të shoqërisë civile vënë theksin mbi një sërë arsyesh të cilat ndikojnë negativisht në përdorimin e kufizuar të legjislacionit nga punonjësit e administratës publike. Ato lidhen kryesisht me kontekstin kulturor, politik, institucional dhe administrativ.

Së pari, sinjalizimi është konceptualisht i vështirë dhe i ngarkuar me paragjykime kulturore dhe konotacione negative. Një sondazh publik mbi qëndrimet ndaj sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor, i realizuar në vitin 2016 ka treguar se vetëm një e treta e njerëzve të anketuar në rajon, përfshirë Shqipërinë, e konsiderojnë sinjalizimin si të pranueshëm.¹² Së dyti, sinjalizimi është i rrezikshëm për politikanët në nivele të larta, për shkak se mund të krijojë probleme serioze politike dhe, për këtë arsye ka pasur pak mbështetje për nxitjen e sinjalizimit në nivelet qendrore të qeverisë.¹³ Gjatë tre viteve të para të zbatimit të tij, asnjë rast sinjalizimi nuk ka ardhur nga punonjës të ministrive edhe pse raporte të Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë evidentuar shkelje financiare të konsiderueshme apo abuzime të ndryshme serioze me licenca gjatë kësaj periudhe.¹⁴ Së treti, nga pikëpamja e zbatimit, Ligji për Sinjalizimin është kompleks për t'u zbatuar dhe kërkon ekspertizë dhe burime të mjaftueshme njerëzore, administrative dhe financiare, të cilat janë të kufizuara.¹⁵

Këto pengesa janë evidentuar edhe nga vetë ILDKPI-ja në raportin vjetor të paraqitur në Kuvend për vitin 2018, ku ndër të tjera theksonte se për rritjen e rezultatshëmrisë së ligjit nevojiten:

- Rritja e ndërgjegjësimit mbi ligjin dhe domosdoshmërinë e zbatimit të tij.
- Bashkëpunim i ngushtë me partnerët për të siguruar mbulimin sa me të gjerë të njohjes dhe ndërgjegjësimit të kuadrit ligjor.
- Trajnim dhe forcim i kapaciteteve.¹⁶

Sinjalizimi dhe raportimi në media

Sinjalizuesit janë një pjesë kryesore e ekosistemit të gazetarisë, duke ofruar orientim dhe këshilla thelbësore për gazetarët gjatë hulumtimeve të tyre. Këta individë ndodhen brenda sistemeve dhe meqenëse kanë akses në informacione mbi korrupsionin ose keqbërjen për të cilat besojnë se është në interes të publikut që të mësohen të sinjalizojnë për këto aktivitete.

¹⁰ www.ildkpi.al/wp-content/uploads/2018/11/Raporti-Vjetor-2017-ILDKPKI.docx

¹¹ www.ildkpi.al/wp-content/uploads/2019/06/Raporti-vjetor-Viti-2018.docx

¹² <https://www.rcc.int/news/239/the-medal-of-the-loud-speak-do-not-keep-silent>

¹³ <http://csdgalbania.org/sq/ligji-per-sinjalizimin-shenon-nje-pershkallezim-ne-perpjekjet-e-shqiperise-per-frenimin-e-korrupsionit-por-a-do-tia-dale/>

¹⁴ http://klsh.org.al/web/buletini_vjetor_compressed_5406.pdf

¹⁵ http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/06/Final_5-Qershor_Raport-i-ndermjetem-i-monitorimit_Sinjalizuesit.pdf

¹⁶ www.ildkpi.al/wp-content/uploads/2019/06/Raporti-vjetor-Viti-2018.docx

Për shkak të çështjeve shpesh sensitive të cilat zbulojnë, gazetarët dhe sinjalizuesit kanë punuar bashkë në shumë çështje zgjidhja e të cilave ka shpënë në ndryshime të mëdha. Në shumë vende gazetarët dhe sinjalizuesit kanë punuar së bashku për mbajtjen përgjegjëse të institucioneve përmes informimit të qytetarëve duke ndihmuar në forcimin e demokracisë. Raste të sinjalizuesve si Mark Felt, punonjësi i FBI, i cili së bashku me gazetarët e Washington Post Bob Woodward dhe Carl Bernstein zbuluan skandalin “Watergate“, i cili shpuri në rrëzimin e presidentit Richard Nixon,¹⁷ apo të Lux Leaks apo *Panama Papers* që hodhën dritë mbi praktika të evazionit fiskal dhe pastrimit të parave nga kompani shumëkombëshe dhe zyrtarë të korruptuar,¹⁸ tregojnë se si bashkëpunimi ndërmjet gazetarëve dhe sinjalizuesve mund të kontribuojë për të avancuar interesat e publikut dhe përmirësuar demokracinë.

Në vende ku praktika e sinjalizimit është akoma e pazhvilluar apo pengohet nga faktorë të tillë si paragjykimi apo identifikimi i sinjalizuesve më kallëzuesit, të cilët denonconin kundërshtarët e regjimeve në vendet ish-komuniste roli i mediave është më i rëndësishëm pasi ndikon në formësimin e opinionit publik mbi sinjalizimin.

Por e kundërta ka ndodhur në kontekstin shqiptar, ku sinjalizimi vazhdon të jetë diçka pothuajse i panjohur ose i njohur fare pak për gazetarët. Kjo më së miri vërehet në raportimin, që i është bërë nga mediat në vazhdimësi procesit të miratimit dhe zbatimit të Ligjit për Sinjalizimin.

Në vend që mediat të raportojnë me vërtetësi dhe në mënyrë korrekte procesin e miratimit dhe zbatimit të Ligjit për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, gazetarët kanë nxituar ta raportojnë sinjalizimin duke ju referuar me konotacionin negativ si “spiunim”.¹⁹

Nga një kërkim i bërë me fjalët “Ligji për Spiunët” në motorin e kërkimit Google, rezulton se pothuajse të gjitha mediat përdorin fjalën “spiun” për titujt që përdorin mbulimin e lajmeve mbi proceset që lidhen me Ligjin për Sinjalizimin dhe zbatimin e tij.²⁰

Edhe pse kanë kaluar katër vite që nga koha kur për herë të parë media mbulonte procesin e diskutimit të ligjit në Kuvend, dhe informacioni mbi sinjalizimin është më i plotë falë edhe punës së organizatave joqeveritare, ende nuk vihet re ndonjë ndryshim në mënyrën e raportimit mbi sinjalizimin nga gazetarët.

Siç e tregojnë edhe gjetjet nga të dhënat e intervistave me gazetare duket se shkaqet janë njohja e pakët e sinjalizimit si praktikë, njohja e pakët e ligjit mbi sinjalizimi dhe një qasje e përgjithshme pothuajse “burokratike” ndaj raportimit.

¹⁷ <https://www.vanityfair.com/news/politics/2005/07/deepthroat200507>

¹⁸ Douglas Dalby and Simon Bowers. “Lux Leaks, Panama Papers spur EU to better protect whistleblowers”. <https://www.icij.org/investigations/panama-papers/lux-leaks-panama-papers-spur-eu-to-better-protect-whistleblowers/>

¹⁹ <http://top-channel.tv/video/spiunet-nuk-raportojne-antikorrupsioni-njesite-ne-administrate-nuk-kane-asnje-efekt/>

– <https://www.balkanweb.com/kuvend-miratohet-ligji-per-spiunet-nis-te-zbatohet-nga-l-tetori/>

– <http://shekulli.com.al/nis-skema-e-spiunazhit-ne-te-gjitha-institucionet-cfare-zbulojne/>

– <http://www.javanews.al/spiunet-ne-institucione-e-kompani-nis-zbatimi-si-do-te-funksionojte-ligji/>

– <https://shqiptarja.com/video/spiunet-ne-administrate-ja-institucionet-qe-u-spiunuan-nga-punonjesit-e-vet>

– <https://www.ballkan.com/blog/2018/07/05/spiunet-si-kane-raportuar-609-persona-ne-shtet-dhe-privat-ja-institucionet-e-spiunuar/>

²⁰ https://www.google.com/search?q=ligji+per+spiunet&ei=kyLbWVvezEoTVwAKR_YnACg&start=0&sa=N&biw=1440&bih=794

Rezultatet e anketës

Duke u nisur nga konteksti i përshkruar më sipër dhe me synimin për të kuptuar më në thellësi shkaqet e inercisë në raportimin mbi sinjalizimin, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes hartoi një pyetësor për të marrë informacion duke pyetur gazetarë nga organet kryesore të medias së shkruar, portaleve dhe asaj vizive nëpërmjet një pyetësoi të strukturuar.

Pyetësoi synonte të vilte të dhëna mbi shkallën e informimit të gazetarëve, shkallën e angazhimit dhe përpjekjet e gazetarëve për të përmirësuar raportimin, mendimin kritik të tyre mbi punën e institucioneve shtetërore, si dhe dhënien e opinioneve për rrugët e mundshme për përmirësimin e raportimit mbi Sinjalizimin.

Nga analizimi i të dhënave të marra rezulton se gazetarët kanë një informim të dobët mbi ligjin dhe sinjalizimin në përgjithësi. Gjithashtu, rezultatet e anketës tregojnë për një shkallë të ulët të angazhimit të gazetarëve për të njohur më mirë ligjin dhe praktikën e sinjalizimit. Mendimi që mbizotëron në mes tyre është se institucionet shtetërore nuk kanë bërë mjaftueshëm për informimin mbi ligjin, ndërkohë që paradoksalisht kujtojmë se mediat nuk janë të varura prej institucioneve shtetërore për të rritur shkallën e tyre të njohjes. Po kështu intervistat tregojnë për një shkallë të ulët të angazhimit të gazetarëve për të ndikuar në përmirësimin e raportimit duke konsideruar se përdorimi i konotacioneve negative mbi ligjin justifikohet pasi rrit lexueshmërinë duke i shkuar përshtatet stereotipit të publikut mbi sinjalizuesit. Nga ana tjetër, angazhimi i madh ndaj politikës i shumë prej gazetarëve, është një energji që merr punën dhe fokusin mbi temat e tjera, përfshirë dhe Sinjalizimit. Angazhimi i ulët vërehet edhe në pasivitetin për sa i përket mënyrave për të adresuar problemin, ku mundësitë e përmirësimit ose nuk shihen ose shihen të rezultojnë vetëm si rezultat i angazhimit të institucioneve shtetërore ose ndërkombëtare.

Shkalla e informimit mbi ligjin dhe sinjalizimin si praktikë

Nga analizimi i të dhënave të marra nga intervistat rezulton se gazetarët shqiptarë kanë një informim të dobët mbi ligjin dhe sinjalizimin në përgjithësi. Ligji thonë ata njihet pak ose aspak prej komunitetit të gazetarëve.

Një nga gazetarët e pyetur shprehet se gazetarët “pothuaj nuk ia kanë fare idenë [e ligjit për sinjalizimin] dhe këtë e ndjej se më duhet të drejtoj një sektor dhe nuk është përmendur as edhe njëherë në këto vitet e fundit. Kam frikë se vetëm një përqind e tyre mund të jetë në dijeni të këtij ligji”.

Nga shumica e përgjigjeve rezulton se sinjalizimi konsiderohet si një fushë specifike raportimi të cilën duhet ta njohin gazetarët që raportojnë mbi ligjet dhe parlamentin dhe nuk e lidhin sinjalizimin me marrjen e informacionit, si pjesë e pandashme e profesionit të gazetarit. Ndërkohë që individë syresh, mendojnë se është politika, fusha që merr të gjithë vëmendjen, duke mënjanuar interesat e tjera. Ka prej tyre që e shohin sinjalizimin si një praktikë të importuar e cila është jashtë kontekstit të Shqipërisë dhe se informimi i mirë apo i dobët i gazetarëve nuk do të sillte ndryshim.

Pothuajse të gjithë gazetarët e intervistuar i referohen ligjit si burim njohje për sinjalizimin ç'ka tregon se nuk kanë pasur informacion të mëparshëm për sinjalizimin si praktikë. Ky boshllëk njohurish të përgjithshme mbi sinjalizimin vë në pah edhe problemin e përmbajtjes së

kurrikulave të fakulteteve të gazetarisë në Shqipëri dhe mungesat që ato kanë në trajtimin e çështjeve që lidhen me sinjalizuesit si burim specifik informacioni.

Shumica e gazetarëve në fakt janë të njohur koncepte dhe praktika të punës me burime anonime, por fakti që sinjalizuesit për shkak se zbulojnë informacione që dëmtojnë interesin publik nga pozitat e njohurisë specifike profesionale thjesht i bën sinjalizuesit një kategori specifike burimi dhe për këtë gazetarët duhet të njohin mirë ligjet që i mbrojnë ata në mënyrë që ti mbrojnë më mirë burimet e tyre. Kjo nuancë nuk rezulton se është e dallueshme nga intervistat, ç'ka sjell në vëmendje edhe nevojën për të bërë dallimin ndërmjet Sinjalizimit dhe “rrjedhjes së informacionit” si kategori të ndryshme burimi. Ndryshe nga Sinjalizimi, i cili është një akt , i cili shërben për të mbrojtur interesin publik, Rrjedhja e informacionit është një veprim i qëllimshëm, i cili shpesh përdoret për të delegitimuar si burimin ashtu edhe informacionin. Rrjedhja e informacionit mund të jetë interesante për publikun, por nuk ekspozon domosdoshmërisht paligjshmërinë, keqbërjet, dëmtim të interesit publik. Shpesh, rrjedhjet janë të motivuara politikisht dhe nuk kanë për qëllim mbrojtjen e interesit publik.²¹

Arsyet përse gazetarët raportojnë negativisht mbi sinjalizimin

Nga përgjigjet e intervistave del se raportimi negativ është i lidhur me mosnjohjen e sinjalizimit si kategori specifike burimi informacioni por dhe me strukturën e tregut të mediave në Shqipëri, e cila është e prirur drejt lajmit të shpejtë dhe komercializmit të lajmeve të nxitur edhe nga konkurrenca nga media online dhe mediat sociale.

Një nga të intervistuarit arsyeton se raportimi negativ lidhet me reminishencën e së shkuarës, mungesën në praktikë të sinjalizuesve dhe sigurisht mosnjohjes së legjislacionit.

Ndërsa një nga intervistuesit thekson se përveç mungesës së informacionit mbi ligjin nga ana e gazetarëve ndikon dhe “vetëcensura dhe linja editoriale e medias ku punojnë”. Për një tjetër raportimi negativ lidhet me qëllimin e “përfitimit të klikimeve dhe sulmin e mazhorancës nën pretendimin se po kthehet diktatura”.

Por shqetësues është fakti se duket se ka një pranueshmëri të përgjithshme, apo edhe justifikim të raportimit negativ mbi sinjalizimin në mes të gazetarëve.

Një nga të intervistuarit, që në fakt i mendon sinjalizuesit si të punësuar me kohë të plotë në funksion të tillë, nënvizon se “e vetmja gjë që mund të bëjë ky ligj [për sinjalizimin] është krijimi i një klimë shantazhi kundrejt sipërmarrësve apo një subjekti tjetër”. Duke e interpretuar sinjalizimin si të tillë, raportimi negativ për disa gazetarë merr trajtën e angazhimit në mbrojtje të sipërmarrjes, e cila kërcënohet nga sinjalizuesit. Më tej, i intervistuari shton se “konotacionet negative duket sikur janë të shkruara në ligj”. Po kështu një tjetër thekson se këto janë “konotacione që shesin”.

Një nga të intervistuarit thekson se “ideja e krijuar [nga ligji] është se [sinjalizuesit] do spiunojnë”. Ndërsa një tjetër, edhe pse është gazetar thekson se “media e përcjell kështu si ligj spiunësh pasi politikanët iniciativat e ngjashme si këtë i identifikojnë me atë që spiunohet”, dhe media shpesh i referohet këtij konotacioni “pasi e ndihmon shumë për audiencë”.

²¹ Udhërrëfyeni për Sinjalizimin dhe Sinjalizuesit në Sektorin e Sigurisë në Shqipëri. <http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2019/10/udherrefyesh02.pdf>. CSDG 2019

Nga ana tjetër kjo qasje vë në pah problemin e formimit etik dhe profesional të gazetareve, i cili bazohet në parime të mirëfillta ndër të cilat parimet e së “vërtetës” dhe “verifikimit”.²² Pra nëse një gazetar nuk e njeh një çështje, ai ose ajo nuk mund të marrë përsipër të raportojë për të, ose nëse e bën duhet ta bëjë duke ndjekur parimet profesionale.

Rrugët për të përmirësuar raportimin

Duke u nisur nga premiset se gazetarët e ushtrojnë profesionin e tyre sepse janë të angazhuar dhe besojnë në parimet themelore të informimit si e drejtë, ata u pyetën edhe për të dhënë mendimet dhe sugjerimet e tyre për të përmirësuar raportimin mbi sinjalizimin.

Shumica e të pyeturve thonë se duhen gjetur mënyra për të informuar gazetarët nëpërmjet trajnimeve, tryezave me tematikë specifike mbi këtë çështje, si dhe diskutime më të shpeshta në platformat e debateve televizive.

Gjithashtu ka mes tyre që sugjerojnë hartimin e një manuali me shembuj sesi sinjalizuesit kanë ndryshuar realitete të caktuara dhe kanë ndihmuar në zgjidhje problemesh në interes të publikut. Kjo është e domosdoshme thekson një nga të intervistuesit pasi “për aq kohë sa gazetarët nuk e kuptojnë këtë ligj si mund t’u vinë në ndihmë këtyre personave që janë krejt pa zë dhe nuk kanë ditur të ngrenë ndonjë problematikë”.

Sidoqoftë, shumë prej të intervistuarve nuk shfaqin se do të kenë ndonjë angazhim më të madh personal në këtë drejtim, dhe sugjerimet e tyre u drejtohen të tretëve. Dikush sugjeron se “qeveria duhet të ndër marrë aktivitete për shpjegimin e ligjit”, dikush tjetër thotë se institucionet duhet “të garantojnë kushte reale që njerëzit të ndjehen të lirë të sinjalizojnë”.

Ka dhe që e shohin si të pamundur përmirësimin, për shkak të dobësisë së shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit. Një nga të intervistuarit thekson se “një sinjalizues është i rrezikuar njësoj kur afrohet tek një gazetar, pavarësisht nëse vendi ka apo jo një ligj për mbrojtjen e sinjalizimit”.

Edhe pse organizatat joqeveritare kanë bërë përpjekje në drejtim të përmirësimit të informimit dhe kuadrit ligjor,²³ ato nuk identifikohen nga gazetarët se mund apo duhet të luajnë ndonjë rol konkret, ç’ka mund të tregojë për një raport të dobët sinergjie ndërmjet mediave dhe OJF-ve.

Duket se klima e brendshme në institucionet e medias duhet emancipuar, ku qasja ndaj Ligjit për Sinjalizuesit, duhet të jetë një nga aspektet që duhet jo thjesht t’u kërkohet por edhe vlerësohet gazetarëve. Po ashtu strukturat e sotme të medias duhet të përshtaten me hallkat e dhura në mënyrë që gazetarët të përballen si duhet me Ligjin, por edhe ndihmën ndaj tij.

²² American Press Association. “Principles of Journalism”. <https://americanpressassociation.com/principles-of-journalism/>

²³https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-Monitorimi_Sinjalizimi-i-korrupsionit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri_Sfidat-e-zbatimit-t%C3%AB-kuadrit-t%C3%AB-ri-ligjor.pdf

– <http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2017/10/Protecting-Whistleblowers-in-SE-Europe.pdf>

– <http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2019/10/udherrefyes02.pdf>

– <https://partnersalbania.org/programs/zbatimi-i-legjislacionit-per-sinjalizimin-dhe-mbrojtjen-e-sinjalizuesve/>

– <https://partnersalbania.org/Gallery/ligji-per-sinjalizimin-dhe-mbrojtjen-e-sinjalizuesve-laë-on-ëhistlebloëing-and-whistleblowers-protection/>

Konkluzione dhe rekomandime

Sinjalizimi është një praktikë relativisht të re për Shqipërinë dhe preokupimi për gjetjen e termit të përshtatshëm ishte gjithashtu një nga çështjet e hasura gjatë hartimit dhe miratimit të ligjit.

Kur kanë kaluar gati më shumë se tre vjet prej hyrjen në fuqi të Ligjit për Sinjalizimin, rezultatet në drejtim të numrit të rasteve të sinjalizimit konsiderohen pothuaj të papërfillshme, dhe po kështu kultivimi i një imazhi adekuat dhe pozitiv mbi sinjalizimin.

Në këtë aspekt raportimi në media ka kontribuar negativisht, ose në rastin më të mirë nuk ka arritur që të ndikojë pozitivisht në formësimin e perceptimit dhe qëndrimit ndaj Sinjalizimit dhe krijimin e një kulture mbështetëse ndaj tij.

Një nga pengesat kryesore për zbatimin e këtij ligji është i lidhur edhe me rolin e medias për të raportuar në mënyrë korrekte dhe për të inkurajuar dhe mbështetur zbatimin e tij. Kjo e fundit në luftën kundër korrupsionit nuk duhet parë si i veçuar, pasi media luan një rol të rëndësishëm në perceptimet e qytetarëve dhe për këtë arsye konsiderohet edhe si një instrument kryesor për denoncimin e akteve korruptive.

Problemi konsiderohet realisht shqetësues, pasi media, një nga pushtetet kryesore të funksionalizimit të shtetit dhe e konsideruar si mbështetës kryesor i ligjit, edhe pas tre vitesh, pothuaj është e paqartë me të, kultivon mendime kontradiktore dhe për më tepër e anatemon indirekt me fjalorin fyes.

Media shqiptare jo vetëm nuk e ndihua procesin duke evokuar rastet e mira të sinjalizuesve por në mënyrë konstante ka raportuar duke përdorur konotacione negative.

Rezultatet e anketës së organizuar me gazetarë tregojnë se problemi vazhdon të mbetet këmbëngulës dhe gazetarët ruajnë qëndrime stereotipike, të cilat vijnë si për shkak të mos informimit por dhe mungesës së interesit nga gazetarët për të përmirësuar njohjen e tyre dhe angazhimit profesional për të raportuar mbi parimet më të mira të gazetarisë.

Duke pasur parasysh zbatimin e dobët të ligjeve në Shqipëri është e vështirë të imagjinohet se ligji i vetëm do të nxitë veprimin e sinjalizuesve.

Në këtë mënyrë, një veprim i bashkërenduar i mediave në bashkëpunim me OJQ-të e angazhuara në këtë fushë por dhe me institucionet e ngarkuara më zbatimin e ligjit mund të shpien në një përmirësim të informimit mbi sinjalizimin si parakusht për çdo veprim të mëtejshëm.

Ndërkohë mediat duhet të bëjnë më shumë për të ndryshuar perspektivën e raportimit të tyre mbi sinjalizimin dhe të rreshtohen përkrah zbatimit të Ligjit. Deri më sot, me shumë pak përjashtime, mbulimi mediatik i procesit të hartimit dhe miratimit të ligjit ka qenë keqinformues dhe i pasaktë.

Megjithë vështirësitë që vijnë nga struktura e mediave në Shqipëri, demokratizimi i i kësaj strukture nëpërmjet përhapjes së mediave online ku gazetarët mund të shprehin lirshëm qëndrimet dhe opinionet e tyre jep një mundësi në të ardhmen që gazetarët të përmirësojnë raportimin në këtë fushë.

Referencat

- Alford, F. C. (2001). *Whistleblowers, broken lives, and organizational power*. Ithaca: Cornell University Press.
- Armstrong, D. (2005, December 12). Delicate operation: hoë a famed hospital invests in a device it uses and promotes; Cleveland Clinic set up the fund that has stock in a maker of a heart surgery system. *Wall Street Journal (Eastern ed.)*, A1,A16.
- Balci, A. (2015). *Sosyal bilimlerde araştırma*. (11th ed.). Ankara: Pegem Akademi.
- Bjørkelo, B. (2013). Workplace bullying after whistleblowing: future research and implications. *Journal of Managerial Psychology*, 28(3), 306-323.
- Castagnera, J. O. (2003). The rise of the whistleblower and the death of privacy: Impact of 9/11 and Enron. *Labor Law Journal*, 54(1), 54-65.
- De George, R. T. (1990). *Business ethics*. (3rd ed.) NewYork: Macmillan Publishing, 1990. 13.
- Dyrmishi, A., Hroni, E., Gjokutaj, E., Whistleblowers protection in Albania: An assessment of the legislation and practice (2013). *Report of Institute for Democracy and Mediation and Konrad Adenauer Stiftung*
- Hallunaj, M., *Sinjalizues apo spiun? (Keq)kuptimi i medias shqiptare në mbulimin e lajmeve mbi sinjalizimin*. Raport i CSDG (2019)
- Hersh, M. A. (2002). Whistleblowers heroes or traitors?: Individual and collective responsibility for ethical behavior. *Annual Reviews in Control*, 26(2), 243-262.
- Mannion, R., Blenkinsopp, J., Powell, M., McHale, J., Millar, R., Snowden, N., and Davies, H., Understanding the knowledge gaps in whistleblowing and speaking up in health care: narrative reviews of the research literature and formal inquiries, a legal analysis and stakeholder interviews; *Health Services and Delivery Research*, No. 6.30; [NIHR Journals Library](#); 2018 Aug.
- Miceli, M. P. (2004). Whistle Blowing research and the insider lessons learned and yet to be learned. *Journal of Management Inquiry*, 13(4), 364-366.
- Zivkovic, K.; *Blowing the whistle in the Balkans; Intern, Legal Policy & Research Unit, International Bar Association* (2019)

Shtojca I – Gazetarët e intervistuar

1. Arsen Rusta Report TV,
2. Besar Likmeta, BIRN
3. Darina Topalli, Ora News
4. Ergys Gjençaj News 24
5. Gjergj Erebara, BIRN
6. Erion Ciku, Report TV
7. Ardit Rada, Javanews
8. Klodiana Lala, News 24
9. Valentina Magani Gazeta Shqiptare,
10. Voltiza Duro, Gazeta Shqiptare Online
11. Fajzi Brahushi, Ora News
12. Gerti Kosovari, Javanews
13. Aleksandra Bogdani, BIRN

Shtojca 2 – Intervista e strukturuar

1. Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili u miratua në vitin 2016 ka më shumë se një vit që po zbatohet në të gjitha institucionet publike me më shumë se 80 punonjës dhe subjektet private me më shumë se 100 punonjës. Sa të informuar mendoni se janë gazetarët mbi qëllimin dhe përmbajtjen e këtij ligji?
2. Trajtimi nga media në përgjithësi mbi sinjalizimin ka qenë i pasaktë, dhe shpesh i ngarkuar me konotacione negative, të tilla si “spiun”, “fuksa”, etj. Pse mendoni se media dhe gazetarët e kanë trajtuar sinjalizimin bazuar në këto përkrahje?
3. Çfarë qasje mendoni se duhet të bëjnë institucionet qeveritare dhe organizatat jo qeveritare për të adresuar/rregulluar këtë problem të raportimit të mediave, pasi kjo ndikon në keqinformimin e qytetarëve dhe formësimin e një kulture negative të sinjalizimit?
4. A dini raste kur individë të ndryshëm u janë drejtuar gazetarëve me qëllim sinjalizimin e rasteve konkrete korruptive të ndodhura në vendet e tyre të punës apo edhe të tjera? Nëse po, si janë trajtuar ato?
5. Bazuar në të dhënat e sondazhit të realizuar në vitin 2017 nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, qytetarët në Shqipëri shprehin një besim të konsiderueshëm në organet e medias. Si mund ti shërbejë ky perceptim gazetarëve investigativë për të nxitur sinjalizues ti afrohen medias me qëllim bërjen publike të rasteve korruptive?
6. Nisur nga keqinterpretimet e shumta të medias mbi sinjalizimin, a mendoni se është e nevojshme të ketë informim më të mirë të gazetarëve mbi sinjalizimin? Çfarë aktiviteteve konkrete mendoni se mund të ndihmojnë në këtë drejtim?
7. Mendoni se trajnime apo forma të tjera të ngjashme do të ndikonin në përmirësimin e raportimit të mediave mbi sinjalizimin?